

**VENDIM  
I ASAMBLESE SË  
PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË  
AJA INVESTMENT SHPK**

**Data e Vendimit: 22.02.2022**

**AJA Investment shpk** ("Shoqëria"), një shoqëri Shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik NUIS L12227009A, me seli në adresën "Sheshi" Avni Rustemi", Nr. 24, Njesia Administrativ nr. 2 Tiranë, mban këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

**ORTAKET E SHOQERISE janë:**

1. **Ilir Leka**, zotërues i një kuote që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë; Ortaku tjetër i shoqërisë Z. Al-awadhi, po ashtu zotërues i kuotës në masën 50%, edhe pse është njoftuar rregullisht nuk ka marrë pjesë në mbledhje.

**RENDI I DITES :**

1. Diskutimi i situatës së rëndë financiare dhe zbatimi i marrëveshjes së ortakëve për financime ndaj shoqërisë;
2. Veprimet e Shoqërisë për shlyerjen e detyrimeve ndaj bankës dhe të tretëve;
3. Shitia e kuotës që shoqëria zotëron pranë Shoqërisë ITALDRURI ELBASAN në masën 56.93% të kapitalit me vlerën 492.295.179 leke ose 4.068.555 euro me qëllim mbulimin e humbjeve të shoqërisë në rast se ortakët nuk kontribuojnë në financime të reja;
4. Autorizimin e administratorit të shoqërisë për të përfaqësuar shoqërinë në transaksionin e shitjes së kuotës te blerës të mundshëm;
5. Të ndryshme.

Ortaku i pranishëm i Shoqërisë përfaqëson kuorumin e nevojshëm pë mbajtjen e kësaj mbledhje dhe në këtë mënyrë përbushen të gjitha kërkesat në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe Statutin e Shoqërisë për vendimmarrjen në këtë mbledhje.

**PËR SA MË SIPËR, ASAMBLEA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE, VENDOSI:**

1. Konfirmohet situata e vështirë financiare e shoqërisë dhe mungesa e vullnetit të ortakut që nuk është paraqitur në mbledhje për të zbatuar marrëveshjen e financimit
2. Ortakët nuk janë në gjendje të vendosin në lidhje me veprimet që duhet të marrë shoqëria për shlyerjen e detyrimeve ndaj Bankës dhe të tretëve




3. Miratohet transferimi i kuotës që shoqëria zotëron në masën 56.93% në kapitalin e shoqërisë ITALDRURI ELBASAN me vlerën 492.295.179 leke ose 4.068.555 euro me qëllim mbulimin e humbjeve të shoqërisë
4. Autorizohet administratori i shoqërisë për të përfaqësuar këtë të fundit në vendimmarrjen e shoqërisë ITALDRURI ELBASAN në lidhje me miratimin e transferimit të kuotës. Administratori ka të drejta dhe kompetenca të plota për përfaqësimin e shoqërisë AJA Investment Shpk në procedurat e gjetjes së blerësit të mundshëm, të negocimit të kontratës, si dhe në të gjitha veprimet e nevojshme juridike për nënshkrimin, lidhjen dhe zbatimit të kontratës për transferimin e kuotës me blerësin e mundshëm, si dhe të çdo dokumenti tjetër që do të jetë i nevojshëm për përbushjen e këtij qëllimi.
5. Ngarkohet administratori i shoqërisë më zbatimin e këtij vendimi

Asnjë vendim tjetër nuk u mor në këtë Mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të AJA Investment shpk.

#### ORTAKU

Ilir LEKA

  
(emër-mbiemër-firmë)



**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË**  
**AJA INVESTMENTS**

Sot më datë 22.02.2022, ora 11, unë e nënshkruara Rudina Koçaj, pasi u ngarkova nga ortakët e shoqërisë AJA INVESTMENTS Shpk me NUIS L12227009A ("Shoqëria"), mbaj procesverbalin e mbledhjes së përgjithshme të ortakëve të Shoqërisë, në përputhje me Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe në përputhje me Statutin e Shoqërisë.

Në mbledhje është i pranishëm vetëm njëri prej ortakëve, Z. Ilir Leka, zotëruar i 50% të kapitalit të shoqërisë, i cili formon kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes dhe vendim-marrjes përkatëse, të cilat janë të një natyre të zakonshme, duke qenë se nuk përfshihen në pikat e përcaktuara nga ligji apo statuti, si çështje që kërkojnë kuorum dhe shumicë të cilësuar.

Ortaku tjetër i shoqërisë Z. Mohammad Al-Awadhi, pavarësisht njoftimit që i është bërë në datën 9 Shkurt nëpërmjet mail dhe njoftimit me postë zyrtare të nisur në datë 10 dhe të marrë prej tij në dorëzim në datën 14 Shkurt 2022, nuk është paraqitur në mbledhje. Për më tepër nga ana e shoqërisë i është nisur në datën e mbledhjes një link në mënyrë që ai të kishte mundësinë e pjesëmarrjen on line në mbledhje, por nuk ka patur nga ana e tij asnjë reagim dhe pavarësisht se është pritur përmjet mail dhe njoftimit me postë zyrtare të nisur, përmjet tij ka patur asnjë tentative përmjet tij të aksesuar linkun e nisur, përmjet tij ka patur asnjë rast që të fundit. Ky ortak është njoftuar në vazhdimësi nga ana e administratorit të shoqërisë përmjet situatën e vështirë financiare, si dhe i është kërkuar disa here mbajtja e mbledhjes së asamblesë. Në asnjë rast nuk ka patur reagim prej tij, sidomos përsa i përket mbajtjes së një mbledhje përmjet tij të diskutuar problematikat e shoqërisë. Ne komunikimet e meparshem referuar komunikimit e elektronik te dates 8 Janar 2021 eshte dakordesuar shitja e kuotave qe ortaku Mohammad Al-Awadhi ka ne shoqerine Aja Investments shpk.

Sa më sipër vijohet me diskutimin e rendit të ditës.

**1. DISKTUTIMI I RENDIT TË DITËS**

Rendi i ditës i njoftuar rregullisht përmjet lidhet me vendimmarrjet e kësaj mbledhje është njoftuar rregullisht nëpërmjet mail dhe nëpërmjet postes rekomande, është si vijon:



1. Diskutimi i situatës së rëndë financiare dhe zbatimi i marrëveshjes së ortakëve për financime ndaj shoqërisë;
2. Veprimet e Shoqërisë për shlyerjen e detyrimeve ndaj bankës dhe të tretëve;
3. Shitja e kuotës që shoqëria zotëron pranë Shoqërisë ITALDRURI ELBASAN në masën 56.93% të kapitalit me vlerën 492.295.179 leke ose 4.068.555 euro me qëllim mbulimin e humbjeve të shoqërisë në rast se ortakët nuk kontribuojnë në financime të reja;
4. Autorizimin e administratorit të shoqërisë për të përfaqësuar shoqërinë në transaksionin e shitjes së kuotës te blerës të mundshëm;
5. Të ndryshme.

Z. Ilir Leka, në cilësinë e ortakut dhe administratorit merr fjalën në lidhje me çështjet e rendit të ditës.

Situata financiare e shoqërisë paraqitet shumë e rëndë. Sipas njoftimeve dhe raportimeve të herëpashershme të Administratorit të shoqërisë, të dy ortakët e shoqërisë janë vënë në dijeni të gjendjes së vështirë financiare si dhe të situatës me bankën, e cila kërkon marrjen e masave për fillimin e ekzekutimit të detyrimit ndaj saj.

Shoqëria duhet të marrë masat për të zvogëluar humbjet dhe për të mos rrezikuar ekzistencën e saj por nën kushtet kur ortaku tjetër 50% nuk i përgjigjet shoqërisë për angazhimet e marra ndaj saj, për të kontribuar në mbulimin e humbjeve të shoqërisë, duhen gjetur mënyrat alternative për të shëmangur falimentin e shoqërisë apo fillimin e procedurave të ekzekutimit të kredisë nga ana e bankës.

Për këtë arsy, pika e tretë e rendit të ditës, sipas të cilat shoqëria mund të shesë kuotën që shoqëria zotëron në subjektin ItalDruri Elbasan në një vlerë 492.295.179 leke ose 4.068.555 euro me qëllim mbulimin e humbjeve të shoqërisë është zgjidhja e vetme e pranueshme që shpëton shoqërinë.

Ortakët e pranishëm në mbledhje janë dakord të procedohet me shitjen e kuotës që zotëria zotëron në shoqërinë e së drejtë shqiptare ItalDruri Elbasan. Duke qenë se shoqëria nuk e ka nënshkruar të gjithë kapitalin tek kjo e fundit, vlera e shlyer është ajo që mund të rikuperohet, ndërsa blerësi i kuotës do të marrë përsipër vlerën e kapitalit të nënshkruar e të pashlyer.

Për këtë qëllim Asambleja e Ortakëve, autorizon Z. Ilir Leka, administrator të shoqërisë, për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha proceduar e nevojshme për shitjen e kuotës në shoqërinë ItalDruri Elbasan, sipas çmimit të sipërpërmendur. Administratori i shoqërisë ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Ortakëve të shoqërisë Ital Duri Elbasan, të miratojë transferimin e kuotës tek ortaku i ri, të lidhë kontratën paraprake të shit-blerës së kuotës duke përcaktuar të gjithë elementët e nevojshëm e të nënshkruaj çdo vendim kontratë apo akt tjetër të domosdoshëm për realizimin e transferimit të kuotës.



Asambleja nuk ka më asnjë çështje tjetër për të diskutuar.

## **2. VOTIMI DHE VENDIMET E ORTAKËVE**

Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë për sa më sipër votojnë vendimet si vijon:

- Ortaku Z. Ilir Leka miraton pikat e diskutuar të rendit të ditës sipas propozimeve të mësipërme pa asnjë kundërshtim.
- Ortaku Z. Mohammad Al-Awadhi, rregullisht i njofuar për të vendosur në lidhje me pikat e rendit teë ditës, nuk mori pjesë në mbledhje dhe as nuk parashroi vendimmarrjen e tij.

## **3. MBYLLJA E VOTIMIT DHE VENDIMET**

Duke u bazuar në votat e ortakëve në lidhje me vendimet e sipërpërmendura, unë e nënshkruara Rudina Koçaj, në përputhje me Statutin e Shoqërisë shpall rezultatet e votimit dhe në këtë mënyrë deklaroj se janë miratuar me votën pro 100% të ortakëve që zoterojnë 50% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, vendimet si më poshtë:

**Vendim Nr.1:** Konfirmohet situata e vështirë financiare e shoqërisë dhe mungesa e vullnetit të ortakut që nuk është paraqitur në mbledhje për të zbatuar marrëveshjen e financimit

**Vendim Nr.2:** Ortakët nuk janë në gjendje të vendosin në lidhje me veprimet që duhet të marrë shoqëria për shlyerjen e detyrimeve ndaj Bankës dhe të tretëve

**Vendim Nr.3:** Miratohet transferimi i kuotës që shoqëria zoteron në masën **56.93%** në kapitalin e shoqërisë **ITALDRURI ELBASAN** me vlerën **492.295.179 leke ose 4.068.555 euro** me qëllim mbulimin e humbjeve të shoqërisë

**Vendim Nr.4:** Autorizohet administratori i shoqërisë për të përfaqësuar këtë të fundit në vendimmarrjen e shoqërisë **ITALDRURI ELBASAN** në lidhje me miratimin e transferimit të kuotës, si dhe në përfaqësimin e shoqërisë në procedurat e lidhje dhe zbatimit të kontratës për transferimin e

**kuotës me blerësin e mundshëm, duke patur të drejta të plota firme,  
negocimi dhe miratimi.**

**Vendim Nr.5:** Ngarkohet administratori i shoqërisë më zbatimin e këtij vendimi

Ortakët e pranishëm

Sekretari

Ilir LEKA



Rudina Koçaj



**KONTRATË  
SHIT – BLERJE KUOTE**

Sot, më datë 04/04/2022 (dymijë e njëzet e dy), Shitësi dhe Blerësi, ranë dakord për hartimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje Kuote me termat e mëposhtme:

**SHITËSIT:** **AJA INVESTMENTS Sh.p.k.**, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NIPT L12227009A, me seli në TIRANE Njësia Bashkiake Nr. 2, Sheshi Avni Rustemi, Nr. 24, përfaqësuar nga Administratori Z. Ilir Leka.

**BLERËSI:** **DIJON ALBANIA Sh.a.**, shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NIPT K81805011P, me seli në TIRANE Njesia bashkiake nr 2, sheshi Avni Rustemi, vila 3-kateshe (ish vila e Vefes), përfaqësuar nga Administratori Z. Silvana Pashako.

**KUSHTE PARAPRAKE**

Shoqëria Tregtare **ITALDRURI ELBASAN Sh.p.k.** është themeluar më datë 10/09/1993 dhe regjistruar me datë 01/07/1996 në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me nr. NIPT J62903222L.

Shoqëria ka një kapital themeltar të regjistruar prej 1.497.049.087 (një miliard e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e dyzet e nëntëmijë e tetëdhjetë e shtatë) Lekë, i ndare në 3 kuota të zotëruara nga Ortakët si vijon:

1. **Shoqëria AJA Investmens**, e cila zotëron 56,93% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë.
2. **Dijon Albania Sh.a**, e cila zotëron 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë.
3. **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**, i cili zotëron 18,07% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë.

Ortaku AJA Investments i cili zotëron 56.93 % të kapitalit të shoqërisë dëshirojnë të tjetërsojë një pjesë të kapitalit që zotëron. Ndërkohë ortaku ka nënshkruar masën prej 56.93% të kuotës por ka shlyer vetëm një pjesë të tij.

Me vendimin datë 22 Shkurt 2022, ortaku AJA Investments ka vendosur të miratojë shitjen e kuotës të zotëruara nga Shoqëria në kapitalin e shoqërisë "Italdruri Elbasan sh.p.k" në masën 56.93% tek blerësi "Dijon Albania sh.a" për një çmim prej 492.295.179 Leke ose 4.068.555 Euro, çmimi i cili merr në konsideratë dhe faktin e kuotës së nënshkruar dhe të pashlyer.



Me shkresen nr. 3672/2 Prot, datë 02.03.2022 ortaku Ministria e Financave dh e Ekonomisë ka vendosur të miratojë pikën 1 të rendit të ditës "Transferimi i masës prej 56.93% të kapitalit të shoqërisë të zotëruar nga ortaku "AJA Investments, në favor të personit të tretë".

Me vendimin datë 02.03.2022, Asambleja e ortakëve të shoqërisë Italdruri Elbasan sh.p.k ka vendosur të miratojë shitjen nga AJA Investments sh.p.k, të kuotës që zotëron në masën prej 56.93% të kapitalit themeltar.

Me vendimin datë 28.02.2022, Asambleja e aksionareve të shoqërisë Dijon Albania sh.a ka vendosur të miratojë blerjen nga AJA Investments sh.p.k, të kuotës që zotëron në masën prej 56.93% të kapitalit themeltar.

Duke qenë se të dy ortakët ka rënë dakord për shitjen e kapitalit të shoqërisë si më sipër palët hartojnë dhe nënshkruajnë këtë kontratë shit-blerje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë sipas parashikimeve si më poshtë vijon:

**Neni 1  
OBJEKTI**

Objekt i kësaj kontrate është shitja e kuotës së kapitalit të shoqërisë "Italdruri Elbasan sh.p.k" në masën prej 56.93% të kapitalit themeltar, që zotërohen nga Ortaku i shoqërisë, shoqëria AJA Investments sh.p.k i cili paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e shitësit dhe blerja e tyre nga shoqëria Dijon Albania sh.a në cilësinë e blerësit. Kuota kalon me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart, sidomos detyrimet e marrë nga ortaku AJA INVESTMENTS kundrejt shtetit shqiptar për realizimin e kontratës TEDA sipas planit të biznesit të miratuar nga palët.

**Neni 2  
KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTËN**

Shitësi AJA Investments sh.p.k humbet pronësinë mbi masën prej 56.93% të kuotës së zotëruar prej tij duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi pjesën e shitur të kapitalit dhe duke humbur cilësinë e ortakut të shoqërisë.

Blerësi Dijon Albania sh.p.k, bëhet pronar i masës prej 56.93% të kapitalit të shitur, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e këtij kapitali duke shtuar pjesën e zotëruar prej tij në kapital në masën 81.93% të kapitalit.

**Pronësia mbi kuotat do të kalojë në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.**

Pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë do të zotërohet si vijon:

- Shoqëria Dijon Albania sh.p.k, do të zotëroj 81.93% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë, në vlerën prej 1,496,778,570 lek.**



- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, do të zotëroj 18,07% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1 kuotë, në vlerën prej 270.517 lek.

#### Neni 3

#### ÇMIMI I SHITJES SË KUOTËS

Çmimi i këtij transaksioni shit – blerje kuotash të shoqërisë ITALDRURI ELBASAN Sh.p.k. do të jetë shuma prej 4.068.555 (kater milion e gjashtedhjete e tete mijë e peseqind e pesedhjete e pese) Euro ose 492.295.179 (katerqind e nentehjete e dy milion e dyqind e nentehjete e pese mijë e njeqind e shtatedhjete e nente) Leke, e cila përfaqëson kuotën e nënskruar dhe shlyer nga shitësi, ndërkohë që Blerësi merr përsipër shlyerjen e pjesës së nënskruar por të pashlyer deri më tani. Modalitetet e shlyerjes së çmimit do të përcaktohet nga palët me marrëveshje të veçantë.

Sipas këtij përcaktimi, Blerësi shoqëria Dijon Albania sh.a, do të paguajë në favor të Shitësit në total shumën prej 4.068.555(kater milion e gjashtedhjete e tete mijë e peseqind e pesedhjete e pese) euro ose 492.295.179(katerqind e nentehjete e dy milion e dyqind e nentehjete e pese mijë e njeqind e shtatedhjete e nente) Leke.

Shuma do të transferohet nga blerësi tek shitësit në llogarinë bankare të mëposhtme:

BANKA: \_\_\_\_\_  
PËRFITUES: Credins Bank  
NR. LLOGARISË: C0100000668903  
IBAN ALL: AL24212110470000000000668903

BANKA:  
PËRFITUES: Credins Bank  
NR. LLOGARISË: C0100000912265  
IBAN EUR: AL30212110470000000000912265

Detyrimet tatimore që lindin nga shitja e kuotës paguhen sipas ligjit.

#### Neni 4

#### DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në 4 kopje të njëjtë në gjuhën shqipe nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë.



Termat e kësaj kontrate, pasi u lexuan prej palëve kontraktuese, u gjetën sipas vullnetit të tyre  
të lirë dhe të plotë dhe ata e nënshkruajnë pa vërejtje.

PALËT

SHITËSIT

AJA INVESTMENTS SH.P.K



BLERËSI

DIJON ALBANIA SH. A



# CREDINS bank

M. Lëshces 16, Date 31.03.2003; NIPT K316088010  
Rr."Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë - Shqipëri  
Tel: +355 4 5353000

ELBASAN, 08/07/2022

Numri Teknik/Technical Number

191943182

Numër Regjistrimi/Registration Nr.

A 2022 18731165

Përdorues/User

CF0754EL HE 07

Data/Data e Veprimit

08/07/2022

Ora/Time

14.49.47.

00956117

I NDERUAR Z.

MARKU ILIR

RUSE

RR SHEMSI HAKA SHTEPI PRIVATE NR 20 ALI DEM  
1101 TIRANE TR

000000191943182 - 001

**Pagese faturash/utilitete C01 00000035650 ITALDRURI ELBASAN SH.P.K.**

PAGESE FATURE/UTILITETE

Shuma	Mon.	Dt. Valuta
-------	------	------------

Company: THESARI TR

50,000.00

ALL

08/07/2022

Bill: 0000000003047658

Pershkrim Veprimi: TE TJERA NGA KUNDRAVAJTE

kodi institucionit (thesari): 1010278

Emri Klientit: ITALDRURI ELBASAN

kodi te ardhurave (thesari): 7115499

Kodi kontrate/abonent: J62903222L

Shuma	Mon.	Dt. Valuta
-------	------	------------

150.00

ALL

08/07/2022

KOMISION PAGESE FATURE/UTILITETE

*Hr. Harush*

TOTAL LLOGARI :

50,150.00

0.00

*CREDINS BANK  
08.07.2022  
S.I.L.A.L.  
ALL*

TOTAL CASH :

VULA DHE NËNSHKRIMET E CREDINS BANK

ënim: Banka nuk mban përgjegjësi për instrukSIONE të gabuara të urdhëruesit

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË**  
**ITALDRURI ELBASAN SHPK**

Sot më datë 02.03.2022, ora 11:00, unë e nënshkruara Rudina Koçaj, pasi u ngarkova nga ortakët e shoqërisë ITALDRURI ELBASAN shpk me NUIS J62903222L ("Shoqëria"), mbaj procesverbalin e mbledhjes së përgjithshme të ortakëve të Shoqërisë, në përputhje me Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe në përputhje me Statutin e Shoqërisë.

Në mbledhje janë të pranishëm ortakët:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë – mbajtës i 18,07% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- Dijon Albania shpk – mbajtës i 25% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- Aja Investments shpk – mbajtës i 56,93% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë

Me prezencën e ortakëve si më sipër, përfaqësues të të gjithë kapitalit të Shoqërisë, formohet kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes dhe vendim-marrjes përkatëse, të cilat janë të një natyre të zakonshme, duke qenë se nuk përfshihen në pikat e përcaktuara nga ligji apo statuti, si çështje që kërkojnë kuorum dhe shumicë të cilësuar.

Sa më sipër vijohet me diskutimin e rendit të ditës.

**1. DISKTUTIMI I RENDIT TË DITËS**

Rendi i ditës i njoftuar rregullisht për ortakët lidhet me vendimmarrjet e kësaj mbledhje është njoftuar rregullisht nëpërmjet mail dhe nëpërmjet postes rekomande, është si vijon:

- 1- Miratimi i transferimit të kuotës së zotëruar nga shoqëria AJA Investment shpk tek ortaku tjetër Dijon Albania SHA;
- 2- Të ndryshme.

Z. Ilir Marku, në cilësinë e administratorit merr fjalën në lidhje me çështjet e rendit të ditës.

Duke qenë se ky transaksion mes ortakëve të Shoqërisë nuk cënon interesat e Shoqërisë dhe gjithashtu është i lejuar nga ligji dhe statuti i Shoqërisë, nuk ka asnjë arsyé për mosmiratimin e tij.



Për këtë arsy, ortakët unanimisht janë dakord të procedohet me transferimin përmes shitjes së kuotës nga ortaku Aja Investments shpk në favor të ortakut tjetër Dijon Albania shpk.

Për këtë qëllim Asambleja e Ortakëve, autorizon Z. Ilir Marku, administrator të Shoqërisë, për të përfaqësuar Shoqërinë në të gjitha procedurat e nevojshme për zbatimin dhe regjistrimin e këtij vendimi

Asambleja nuk ka më asnjë çështje tjetër për të diskutuar.

## 2. VOTIMI DHE VENDIMET E ORTAKËVE


Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë për sa më sipër votojnë vendimet si vijon:

- Ortaku Ministria e Financave dhe Ekonomisë miraton pikat e diskutuara të rendit të ditës sipas propozimeve të mësipërme pa asnjë kundërshtim.
- Ortaku Dijon Albania shpk, miraton pikat e diskutuara të rendit të ditës sipas propozimeve të mësipërme pa asnjë kundërshtim.
- Ortaku Aja Investments shpk, miraton pikat e diskutuara të rendit të ditës sipas propozimeve të mësipërme pa asnjë kundërshtim.

## 3. MBYLLJA E VOTIMIT DHE VENDIMET

Duke u bazuar në votat e ortakëve në lidhje me vendimet e sipërpërmendura, unë i nënshkruari Rudina Koçaj, në përputhje me Statutin e Shoqërisë shpall rezultatet e votimit dhe në këtë mënyrë deklaroj se janë miratuar me votën pro 100% të ortakëve që zotërojnë së bashku 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, vendimet si më poshtë:

Vendim Nr.1: **Miratohet transferimi i kuotës së zotëruar nga shoqëria AJA Investment tek ortaku tjetër Dijon Albania SHA**




**Vendim Nr.2:** Autorizohet autorizon Z. Ilir Marku, administrator të Shoqërisë, për të përfaqësuar Shoqërinë në të gjitha procedurat e nevojshme për zbatimin dhe regjistrimin e këtij vendimi.

**Ortakët e pranishëm**

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**


Përfaqësuar nga:

  
**Dijon Albania shpk**

Përfaqësuar nga Administratorja

Znj. Silvana Pashakodijon ALB



  
**Aja Investments shpk**

Përfaqësuar nga Administratori

Z. Ilir Leka



**Sekretari**

Rudina Koçaj



**VENDIM  
I ASAMBLESË SË  
PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË  
ITALDRURI ELBASAN SHPK**

**Data e Vendimit: 02.03.2022**

**ITALDRURI ELBASAN shpk** (“Shoqëria”), një shoqëri Shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtare, në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik NUIS J62903222L, me seli në adresën Lagja Sknderbej, Zona Industriale Jug, Elbasan, mban këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

**ORTAKET E SHOQERISE** janë:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë – mbajtës i 18,07% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
2. Dijon Albania shpk – mbajtës i 25% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
3. Aja Investments shpk – mbajtës i 56,93% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë

**RENDI I DITES :**

1. Miratimi i transferimit të kuotës së zotëruar nga shoqëria AJA Investment shpk tek ortaku tjetër Dijon Albania SHA;
2. Të ndryshme.

Me prezencën e ortakëve si më sipër, përfaqësues të të gjithë kapitalit të Shoqërisë, formohet kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes dhe vendim-marrjes përkatësen dhe në këtë mënyrë përbushen të gjitha kërkesat në përputhje me Ligjin Shqiptar dhe Statutin e Shoqërisë për vendimmarrjen në këtë mbledhje.

**PËR SA MË SIPËR, ASAMBLEA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE, VENDOSI:**

**Vendim Nr.1:** **Miratohet transferimi i kuotës së zotëruar nga shoqëria AJA Investment tek ortaku tjetër Dijon Albania SHA**


**Vendim Nr.2:** **Autorizohet autorizon Z. Ilir Marku, administrator të Shoqërisë, për të përfaqësuar Shoqërinë në të gjitha procedurat e nevojshme pwr zbatimin dhe regjistrimin e kwtij vendimi.**

Asnjë vendim tjetër nuk u mor në këtë Mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të ITALDRURI ELBASAN shpk.

**Ortakët e Shoqërisë**

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**


Përfaqësuar nga:



**Dijon Albania shpk**

Përfaqësuar nga Administratorja

Znj.Silvana Pashako



**Aja Investments shpk**

Përfaqësuar nga Administratori

Z.Ilir Leka







REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 3679/ Prot.

Tiranë, më 2 - 3 2022.

### A U T O R I Z I M

Në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nen 85 “Përfaqësimi në asamble”, me cilësinë e Ortakut Shtetëror në shoqërinë “Italdruri” shpk Elbasan, autorizoj Znj. Suzana Hoxha, Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Pronës Shtetërore dhe Znj. Gjinovefa Arizaj, Specialist në Drejtoren e Administrimit të Pronës Shtetërore, të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, që do të mbahet në datën 2 Mars, ora 11:00 në selinë e shoqërisë.





REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 3672 / Prot.  
/  
2

Tiranë, më 2.3.2022

Lënda: Qëndrimi që do të mbahet në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në shoqërinë “Italdruri” shpk Elbasan

Bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me cilësinë e Ortakut Shtetëror në shoqërinë “Italdruri” shpk Elbasan, në mbledhjen e datës 2 Mars 2022 ora 11:00, mban qëndrimin si më poshtë:

1. Miraton pikën 1 të rendit të ditës “Transferimi i kuotës së zotëruar nga shoqëria AJA Investment tek ortaku tjetër Dijon Albania sha”.

MINISTËR  
Delina IBRAHIMAJ

**SHOQËRIA TREGTARE  
DIJON ALBANIA SH.A  
K81805011P**

**VENDIM**

**I**

**ASAMBLESË TË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE**

Më datë 28/02/2022, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “DIJON ALBANIA SH.A”, për të shqyrtuar dhe vendosur mbi rendin e ditës si më poshtë:

1. Miratimin e blerjes së kuotës së shoqërisë “Italdruri Elbasan sh.p.k” në masën prej 56.93% të zotëruar nga shoqëria “AJA Investments sh.p.k”.
2. Të ndryshme.

Të pranishëm në mbledhje janë të gjithë aksionarët e shoqërisë, dhe konkretisht:


1. **Dritan Pashako**, i cili zotëron 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 1000 aksione.

Duke qenë se vërtetohet vlefshmëria e mbajtjes së kësaj mbledhje dhe kuorumi i nevojshëm përmarrjen e vendimeve, procedohet me diskutimin e rendit të ditës si më sipër.

Aksionari i vetëm i shoqërisë të sipërcituar morën në shqyrtim propozimin për blerjen e kuotës së shoqërisë Italdruri Elbasan sh.p.k në masën prej 56.93% të kapitalit themeltar.

Nga shqyrtimi i propozimit rezulton se shoqëria AJA Investment sh.p.k ka shprehur vullnetin për shitjen e 56.93% të kapitalit të zotëruar prej saj në shoqërinë Italdruri Elbasan sh.p.k., me çmimin prej **4.068.555** (kater milion e gjashtedhjete e tete mijë e peseqind e pesedhjete e pese) euro ose **492.295.179** (katerqind e nentedhjete e dy milion e dyqind e nenetedhjete e pese mijë e njeqind e shtatedhjete e nente) Leke. Ky vullnet i është shprehur shoqërisë Dijon Albania sh.p.k, e cila nga ana tjetër ka shprehur vullnetin për blerjen e kuotës me çmimin e sipërpërmendor.

Shoqëria AJA Investments sh.p.k humbet 56.93% të kapitalit që zotëron në shoqërinë Italdruri Elbasan sh.p.k dhe nuk do të kenë më asnjë pretendim mbi këtë pjesë të kapitalin. Kjo pjesë e kapitalit kalon në favor të shoqërisë Dijon Albania sh.a, e cila ja shton këtë masë pjesës që zotëron tashmë në kapitalin e shoqërisë Italdruri Elbasan sh.p.k duke patur një zotërim total prej 81.93% të kapitalit të kësaj të fundit.



Për sa më sipër, dhe në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", do të lidhet dhe kontrata përkatëse e shitblerjes së kuotave ndërmjet Shitësit Shoqëria AJA Investments sh.p.k blerësit Shoqëria Dijon Albania sh.a.

Pas diskutimit të rendit të ditës dhe duke mos patur pikë tjetër për të diskutuar dhe vendosur, Asambleja e Ortakëve, në mbështetje me Statutin e Shoqërisë dhe ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë blerjen e kuotës së kapitalit të shoqërisë "Italdruri Elbasan sh.p.k", të zotëruar nga ortaku shoqëria AJA INVESTMENTS sh.p.k, në masën prej 56.93% të kapitalit të me çmim **4.068.555** (kater milion e gjashtedhjete e tete mijë e peseqind e pesedhjete e pese) Euro ose **492.295.179** ( katerqind e nenedhjete e dy milion e dyqind e nenetedhjete e pese mijë e njeqind e shtatedhjete e nente) Leke.
2. Caktohet administratori i shoqërisë të përfaqësojë shoqërinë në procedurat e nevojshme për negocimin, hartimin, lidhjen dhe zbatimin e kontratës dhe kryerjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

AKSIONARI

DRITAN PASHAKO

